

AMANETIN E BABËS E ÇOVA NË VEND U KTHEVA NË TETOVË NGA AMERIKA

Berat (Gajur) DERRALLA

Të dashur të pranishëm, shumë i respektuari profesor Arsim Sinani, të nderuar mysafir, profesorë, intelektualë, dashamir.

Është një nder i vecantë për mua që të them disa fjalë në këtë aktivitet kaq të rëndësishëm për Ne, si familje por edhe për qytetin e Tetovës, aty ky jetoi, veproi dhe frymoi gjyshi ynë Mehmet Deralla.

Sic e dini familja jonë pas pavarësisë së shtetit shqiptar vazhdoi me përpjekjet që trojet shqiptare që mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë mos të tjetërsohen, por sic e dini fati ynë ishte i hidhur.

Rininë time më shumë e kalova duke u enduar nga Shkupi dhe Tetova sepse sic e dini babai im, Gajur Deralla, konsiderohej armik i regjimit komunist në Maqedoni dhe ai pjesën më të madhe e kaloi nëpër burgje. Më pastaj ne vendosëm që të arratisemi për në Amerikë, atje ku babai i vazhdoi përpjekjet e tij për çështjen shqiptare. Por fati e deshi që ai shpejtë të ndërrojë jetë. Në kujtimet e mia kam shumë për të thënë, por për këtë me një rast tjetër. Më lejoni që sot me ju të ndaj një brengë të cilën gjatë gjithë jetës sime e kam bartur si thes mbi shpinë. Babai më la amanet që të kthehem në Tetovë dhe sot e them me shumë dashamirësi para jush se jam shumë i lumtur që më në fund jam në mesin tuaj. Ju flim tetovarëve dhe gradecarvë që më mirëpritën dhe më ndihmuan gjithë këto vite. Më vjen mirë që sot në Tetovë, edhe pse pas shumë vuajtjeve dhe sakrificave sërish Ne, familja Deralla jemi bashkë dhe takohemi në qytetin ku lindëm por nuk arritëm të rritemi sepse pushteti na dëboi dhe na konfiskoi gjithcka cka kishim.

Por sic thotë populli kjo pasuri e jona mbetet trashigimi e popullit shqiptar në Maqedoni dhe unë jam shumë krenar që jam kthyer në

vendlindjen time, pavarësisht se padrejtësitë që janë bërë ndaj nesh edhe sot nuk janë përmirësuar. Por mbetem krenar dhe mbi të gjitha për Ne është atdheu, kombi, idealet dhe synimet e familjes tonë gjithnjë ka qenë dhe mbetet që të kontribuojmë për të mirën e kombit tonë.